

VENDIM
Nr. 889, datë 19.12.2012

**PËR LEJIMIN E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË UJËSJELLËS - KANALIZIMEVE
PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT, ME OBJEKT “FURNIZIMI ME UJË
I PLAZHEVE DURRËS - KAVAJË, NGA PUSHPIMET E ÇERMËS, LOTI III, (LINJAT E
UJËSJELLËSIT NGA PIK 235 (DEGËZIMI NË KAVAJË) DERI NË DEPON E RE 4000 M³ NË
ARAPAJ, DEPO ARAPAJ 4000 M³)”, SI AUTORITET KONTRAKTOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjetllës - Kanalizimeve, si autoritet kontraktor, të vazhdojë të kryejë, brenda datës 31 dhjetor 2012, procedurat e prokurimit, me objekt “Furnizimi me ujë i plazheve Durrës - Kavajë, nga pusshpimet e Çermës, loti III (linjat e ujësjetllësit nga PIK 235 (degëzimi në Kavajë) deri në depon e re 4000 m³ në Arapaj, depo Arapaj 4000 m³)”.

2. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetllës-Kanalizimeve dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha